



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Kati I, Tiranë
Website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

Përditësim nga AMSHC NR. 3

26.11.2014

AMSHC propozon krijimin e një Fondi të Përbashkët me donatorët e tjerë për mbështetjen e projekteve të përbashkëta me rëndësi strategjike për vendin

Në 17 nëntor 2014, Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mbajti mbledhjen e radhës, ku krahas problemeve të tjera lidhur me punën e AMSHC-se, Bordi diskutoi edhe një çështje mjaft të rëndësishme lidhur me shpërndarjen e fondeve në mbështetje të nismave strategjike të shoqërisë civile në dobi të komunitetit.

Anëtarët e Bordit diskutuan rreth fushave dhe procedurave të financimit të projekteve në tërësi dhe ndër të tjera ata propozuan krijimin e një fondi të përbashkët me donatorët e tjerë që operojnë në vendin tonë. Më konkretisht u propozua që të caktohet shuma prej 20% të fondit total të grantit si pjesë përbërëse e fondit të përbashkët me donatorët e tjerë, për të financuar projekte të mëdha me rëndësi strategjike për vendin.

Në këtë takim u propozua, gjithashtu, që në bashkëpunim me donatorët e tjerë, të përcaktohen fushat për të cilat kërkohet të

bashkëpunohet si dhe roli që do të ketë AMSHC-ja në shpërndarjen e fondit të përbashkët, për mënyrën dhe rregullat që duhet të përdoren për financimin e projekteve të përbashkëta.

Disa anëtare të Bordit propozuan gjithashtu, që AMSHC-ja, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv së bashku me një përfaqësues të Bordit Mbikëqyrës, të zhvillojnë takime intensive me secilin prej donatorëve ku të bien dakord për krijimin e këtij fondi të përbashkët duke identifikuar dhe profilet e interesit të donatorëve në funksion të një projekti të përbashkët madhor gjatë vitit 2015 si dhe të synohet vazhdimësia për 2016-ën e në vazhdim.

Si përfundim, u vendos që 20% e fondit të grantit të AMSHC-së të jetë pjesë e fondit të përbashkët dhe të shkojë për financimin e projekteve strategjike të cilët do të financohen edhe nga donatorët e tjerë që operojnë në vendin tonë.

Tiranë, 18 nëntor 2014

Aktiviteti "Promovimi dhe Përkrahja e Sipërmarrjes së të Rinjve: Përfitimet dhe Programet"

Të rinjtë janë në zemër të shoqërisë dhe gjithashtu në zemër të sfidave që shoqëria përballet për shkak të urbanizimit të vazhdueshëm dhe përzierjes demografike, traditave të konsumit si dhe të rritjes së pritshmërive sa i përket cilësisë së jetës.

Të rinjtë janë duke u bërë gjithnjë e më shumë një pikë qendrore e shoqërisë sonë në teresi, veçanërisht për shkak të problemit të papunësisë si dhe të probleme të tjera sociale.



Sipërmarrja e të rinjve është një nga qasjet më të mira për mënyrën se si ata mund t'i përgjigjen sfidave të transformimit urban dhe nevojës së vazhdueshme për përparimin.

Aktiviteti i mbajtur sot, "Promovimi dhe Përkrahja e Sipërmarrjes së të Rinjve: Përfitimet dhe Programet", u organizua në një tryezë të rrumbullakët, ku Instituti Adriapol, Universiteti Marin Barleti, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) dhe sipërmarrës, kanë diskutuar mbi rëndësinë dhe përfitimet nga veprimtaria sipërmarrëse si dhe programeve aktuale dhe atyre të ardhshme, që kanë për qëllim mbështetjen dhe promovimin e Sipërmarrjes si dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte të nxirrte në pah veprimet e nevojshme për të miratuar një qasje ndërsektoriale në politikat mbështetëse për sipërmarrjen ekzistuese të të rinjve.

Përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Erion Banushi, Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit" theksoi tre momente kyçe të politikave të agjencisë:

1. *Objektivat e AMSHC-së si një ent publik: të ndihmojë për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile, në përputhje me strategjitë qeveritare në sektorët përkatës.*
2. *Prioritetet e AMSHC-së: të forcojë bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm, në mënyrë që të përfitojë nga programet financuese të tyre.*
3. *E treta dhe më e rëndësishme, në kuadrin e bashkëpunimit me të rinjtë me nisma të tjera të reja, AMSHC ka si prioritet të mbështesë organizatat e reja dhe sipërmarrjen, për të qenë aktivë si aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile.*

Përfaqësuesi i Sipërmarrjeve Rinore, z Idaver Sherifi (www.albeu.com) theksoi disa faktorë të rëndësishëm të sfidave të sipërmarrjes.

Vetë sipërmarrja është një kombinim i ideve të reja dhe i një punë të vështirë, e adaptueshme kundrejt rrethanave mbizotëruese në shoqërinë tonë.

Në mënyrë që të ketë një sipërmarrje të suksesshme, ne duhet të dimë shumë mirë legjislacionin dhe trendet e tregut. Krijimi i rjetit bashkëpunues me aktorët e tjerë që operojnë në të njëjtën fushë ose të ngjashme, është një tjetër element kyç i suksesit për të parandaluar mbivendosjen dhe dështimin e iniciativave.

Valletta (Maltë), 13 nëntor 2014

AMSHC bën Shqipërinë anëtare të Bordit të VOLONTEUROPE

Shqipëria është prej këtij nëntori anëtare e Bordit Ndërkombëtar të VOLONTEUROPE, rrjeti i njohur evropian që promovon vlerat e qytetarisë aktive dhe vullnetarizmit prej 23 vitesh.

Gjatë takimit të datës 13 nëntor në Maltë, përfaqësuesi i Agjencisë shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z.Ismail Ademi ka dalë fitues për një nga dy vendet vakante në Bordin Ndërkombëtar prej 9 anëtarësh pas votimit nga përfaqësues të 51 organizatave.

Megjithëse Shqipërisë i mundësohej vetëm një votë, ajo e drejtorit të AMSHC-së, z.Andi Kananaj, z. Ismail Ademi arriti të merrte shumicën e votave bashkë me Prof.Dr.Doris Rosenkranz e Universitetit të Nurembergut.

Rrjeti ka në përbërje 51 organizata anëtare dhe bashkëpunon në mënyrë konstante me institucionet evropiane, Komisionin Evropian, Parlamentin, Këshillin e Evropës.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) e Shqipërisë është së fundmi anëtare me të drejta të plota e rrjetit.



Marie Louise Cole (Presidentja e Maltës)

Takimi i këtij viti u realizua nën patronazhin e presidentes së Maltës, Marie Louise Coleiro.

Presidentja e Maltës ndau edhe 9 çmimet vjetore të VolontEurope për 2014-n, mes të cilëve u vlerësua me çmim edhe aktivistja shqiptare Marsida Bandilli, studente e Universitetit të Antwerpit, Belgjikë.



Podgoricë (Mal i Zi), 7 - 9 nëntor 2014

AMSHC merr pjesë në Forumin Freja në Podgoricë të Malit të Zi



Në Podgoricë është zhvilluar Forumi "Freja", i cili ka për qëllim rritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Turqisë dhe Evropës.

Përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Erion Banushi, Përgjegjës i "Sektorit të Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit", është i ftuar në këtë forum si folës në seminarin me temë: "Strategjia rajonale e bashkëpunimit midis qeverisjes vendore dhe organizatave që operojnë në nivel lokal".



Z. Banushi ka shpjeguar rolin e rëndësishëm që kanë OSHC-të në zhvillimin e zonave të prapambetura dhe rëndësinë e bashkëpunimit me autoritetet lokale për një zhvillim të qëndrueshëm.

Forumi "Freja" është një aktivitet që zhvillohet një herë në vit dhe vitin e ardhshëm do të zhvillohet në Kosovë.

5 - 6 nëntor 2014

Takime konsultative "Ndajmë vizionin e përbashkët për bashkëpunim strategjik", në qytetet Lezhë dhe Shkodër

Me synim fillimin dhe zhvillimin e një bashkëpunimit të frytshëm dhe të suksesshëm midis AMSHC-së dhe Shoqërisë Civile; AMSHC-ja organizoi ciklin e dytë përmbyllës të takimeve konsultative në datat 5 dhe 6 nëntor 2014, përkatësisht në qytetet Lezhë dhe Shkodër nën moton:

"Ndajmë vizionin e përbashkët për bashkëpunim strategjik"

Në këto takime u vu re një pjesëmarrje e gjerë e përfaqësuesve të OJF-ve nga grupmosha dhe interesa të ndryshme, por ajo që ra në sy ishte pjesëmarrja e përfaqësuesve të të rinjve dhe grupeve shoqërore me probleme sociale.



Pjesëmarrësit, nëpërmjet një pyetësoari të shpërndarë paraprakisht si dhe një dialogimi të hapur, shprehën mendimet dhe sugjerimet e tyre shumë të vlefshme, lidhur me problematikat që ata hasin dhe fushat ku duhet të përqendrohet më shumë mbështetja financiare e AMSHC-së për t'u ardhur në ndihmë, në mënyrë që të realizojnë sa më mirë misionin për të cilin ato janë krijuar.



Mendimet dhe sugjerimet e tyre do të gjejnë zbatim në punën tonë për një planifikim sa më mirë të punës për vitin 2015 si dhe për hartimin e strategjisë afatmesme dhe afatgjatë të AMSHC-së, për të mbështetur fuqishëm shoqërinë civile në nismat e saj civile në ndihmë të komunitetit.

Mendimet dhe sugjerimet që dolën nga diskutimet ishin:

1. Kërkesa për ndihmë konkrete kryesisht për shtresat e varfra të shoqërisë;
2. Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara;
3. Mbështetje financiare specifikisht për fëmijët me aftësi të kufizuara; si dhe integrimin e tyre në shoqëri;
4. Ngritjen profesionale të stafëve të cilët merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me personat me aftësi të kufizuara të natyrave të ndryshme;
5. Trajnimin jo vetëm të stafëve që merren me personat me aftësi të kufizuara, por dhe të familjeve të tyre, të cilët janë në lidhje direkte me këtë kategori në nevojë;
6. Trajnimin profesional të të rinjve dhe të grave të familjeve të shtresave të varfra;
7. Mbështetje për komunitetin rom, si dhe mbrojtja e të drejtave të tyre;
8. Mbështetje financiare për arsimimin e tyre;
9. Të tregohet interes për kulturën romë, integrimin e tyre në shoqëri;
10. Mbështetje e drejtpërdrejtë për shërbime sociale;
11. Mbështetje financiare për mundësimin e arsimimit për fëmijët jetim;
12. Trajnimin e grave kryefamiljare, me qëllim punësimin e tyre dhe krijimin e pavarësisë ekonomike;
13. Punësimi i të rinjve;
14. Ngritja e kapacitete të shoqatave;
15. Një nga pjesëmarrësit u shpreh pozitiv për krijimin e këshillit kombëtar për shoqërinë civile;
16. Lehtësimin pse jo dhe heqjen e taksave për OJF-të;
17. Nxitja e vullnetarizmit; dhe vlerësimi tij me çmime stimuluese

Tetor 2014

AMSHC pranohet si anëtare e VOLONTEUROPE



Pas një procesi që zgjat prej disa muajsh, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është

pranuar si anëtare me të drejta të plota e Rrjetit Evropian (VOLONTEUROPE).

Ky rrjet ndërkombëtar punon për të promovuar vlerat e vullnetarizmit, të qytetarisë aktive dhe drejtësisë sociale, në nivel evropian dhe më gjerë. Aktualisht ky rrjet ka në përbërjen e saj 51 organizata anëtare dhe bashkëpunon në mënyrë konstante me institucionet evropiane (Komisioni Evropian, Parlamenti, Këshilli i Evropës).

Volonteuropë punon prej vitesh në ndërtimin e rrjeteve bashkëpunuese ndërmjet organizatave partnere dhe aktorëve institucionalë, ashtu si dhe në fushën e lobimit për sa i përket temave të trajtuara.

Në vitin 2011 ka qenë rrjeti iniciator i "Vitet Evropian të Vullnetarizmit". Anëtarësimi i AMSHC-së në këtë rrjet të rëndësishëm, do t'i zgjerojë mundësitë e bashkëpunimit evropian të vetë institucionit, por njëkohësisht do të jetë edhe një mundësi për organizatat e shoqërisë civile shqiptare, që të dalin gjithnjë e më përtej kufijëve kombëtarë.